

Simone de.
Beauvoir
Të pandarat



Letërsi e huaj bashkëkohore
Simone de Beauvoir
Të pandarat
DITURIA

Simone de Beauvoir

Të pandarat

Përktheu: Diana Çuli

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:
Simone de Beauvoir
Les inséparables

Redaktore: Mariana Ymeri
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© Éditions de l'Herne, 2020
All rights reserved
Copyright © për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit Europian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.

Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503
E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al
■ Shtëpia Botuese DITURIA

Për Zazën

Nëse sonde sytë më janë mbushur me lot, kjo ndodh sepse ju keni vdekur apo sepse unë kam mbetur këtu e po jetoj? Duhej t'jua kushtoja juve këtë histori: por e di se nuk jeni më asgjëkund dhe po ju drejtohem përmes këtij artifici letrar. Tekefundit, kjo nuk është vërtet historia juaj, por vetëm një histori e frymëzuar nga ne të dyja. Ju nuk jeni Andrea, as unë nuk jam ajo Silvia që flet në emrin tim.

Kapitulli 1

N ë moshën nëntëvjeçare isha vajzë shumë e mbarë; nuk kisha qenë gjithnjë e tillë; gjatë viteve të para të fëmijërisë, tirania e të rriturve më shkaktonte zemërimet kaq të furishme sa një ditë njëra nga tezet e mia tha me shumë seriozitet: “Silvinë e kanë pushtuar djajtë”. Lufta dhe feja më ndryshuan. Dhashë shpejt dëshmi patriotike duke shkelur fort me këmbë një kukull plastike “made in Germany” që, në të vërtetë, nuk më kishte pëlqyer kurrë. Më mësuan se nga sjellja e mirë dhe besimi im në fe varej dhe shpëtimi i Francës, me vullnet të Zotit: pra, nuk kisha nga t’ia mbaja. Bëja shëtitje nëpër bazilikën e Sacré-Cœur-it bashkë me vajza të tjera të vogla, duke tundur afishe e duke kënduar. Fillova të lutesha me gjithë shpirt, gjë që filloi të më pëlqente. Abati Dominik, kapelan në kolegjin Adelaide ma nxiti edhe më përkushtimin. Kungimin e parë e bëra e veshur me një fustan prej tyli, me kapelë me rripa prej dantelle irlandeze: prej asaj dite motrave të mia më të vogla u përmendesha si shembull. Lutjet e mia u dëgjuan nga Zoti, sepse im atë u transferua në Ministrinë e Luftës, ngaqë vuante nga zemra.

Por atë mëngjes, isha në kulm të ngazëllimit; ishte dita e parë e shkollës: mezi prisja sa të kthehesha përsëri në klasë, te mësimet solemne si një meshë, te heshtja e korridoreve, te buzëqeshja e ëmbël të zonjësive të reja. Ato vishnin funde të gjata e bluza të kopsitura deri në qafë dhe, qëkur njëra pjesë e ndërtesës ishte shndërruar në spital, shpesh mbanin edhe uniforma infermieresh. Poshtë velit të tyre të bardhë, vende-vende me njolla gjaku, ngjanin si shenjtoresh dhe më mallëngjenin, sa herë më shtrëngonin në kraharor. E gëlltita përnjëherësh supën dhe bukën pa shije që zëvendësonin çokollatën e ngrohtë dhe brioshët e paraluftës dhe prita me padurim që mamaja të mbaronte së veshuri motrat e mia. Të tria mbanim veshur mantele gri në bojë qielli, të qepura me cohën e uniformave të oficerëve, të prera njësoj si kapotat ushtarake.

“Shikoni, kanë edhe këtë rripkën e vogël nga prapa!” u thoshte mamaja shoqeve të saj, që vështronin me admirim ose me habi. Kur dolëm nga ndërtesa, mamaja kapi për dore dy më të voglat. Kaluam në heshtje përpara kafenesë La Rotonde, që sapo ishte hapur me bujë të madhe poshtë apartamentit tonë dhe që, sipas babait, ishte një strofull e disfatistëve; mua më zgjonte kureshtjen ajo fjalë. “Janë ata që besojnë në humbjen e Francës”, më shpjegonte babai. “Duhet pushkatuar të gjithë”. Nuk kuptoja gjë prej gjëje. Kur besojmë në diçka, ne nuk e bëjmë me ndonjë qëllim të caktuar: a mund të ndëshkohemi nëse na mbijnë disa ide në kokë? Spiunët që u shpërndanin fëmijëve bonbone të helmuara ose ata që shponin gratë franceze në metro me gjilpëra të infektuara, padyshim që e meritonin vdekjen: por disfatistët më çorodisnin. Nuk u lodha së pyeturi mamanë: ajo gjithnjë përgjigjej me po ato fjalë që thoshte babai.

Motrat e mia të vogla nuk ecnin dot shpejt; parmakët e hekurt të Kopshtit të Luksemburgut m’u dukën të pambarimtë. Më në fund hyra në derën e kolegjit, ngjita shkallët, duke lëkundur me gëzim çantën e mbushur me librat e rinj; ndjeva erën e lehtë të sëmundjes që përzihej me erën e dyllit të dyshemesë së korridoreve të sapopastruara; disa kujdestare më përqaftuan. Te gardëroba takova shoqet e mia të vitit që shkoi; nuk isha miqësuar shumë me asnjërën prej tyre, por e doja zhurmën që bënim të gjitha bashkë. U vonova te salloni i hyrjes, përpara vitrinave mbushur me sende të vjetra të vdekura, që po ia dilnin të vdisnin për herë të dytë: zogj të balsamosur, që po u binin pendët, bimë të thara që po shkërmoqeshin, guaska që çdo ditë humbnin shkëlqimin. Ra zilja dhe hyra në klasën Sainte-Marguerite; të gjitha klasat e shkollës dukeshin njësoj. Nxënëset uleshin rreth tryezës ovale mbuluar me lëkurë të zezë moleskin, në krye të së cilës qëndronte mësuesi; nënat tona zinin vend prapa nesh dhe na vështronin, duke thurur kapuçë leshi. Eca drejt stolit tim dhe pashë se te vendi ngjitur ishte ulur një vajzë e imët, e panjohur: e zeshkët me faqet e futura, e cila m’u duk shumë më e vogël se unë; sytë e errët e të ndritshëm më shikuan ngultazi.

- Ti je e para e klasës?

- Jam Silvi Lëpazh,- thashë unë.- Po ti si e ke emrin?

- Andre Galar. Jam nëntë vjeçe; dukem më e vogël, sepse jam djegur dhe prandaj nuk hodha më trup. M’u desh të ndërprisja shkollën për një vit, por

mamaja tani do që të rifitoj kohën e humbur. A mund të m'i japësh për ca kohë fletoret e tua të vitit të kaluar?

- Patjetër,- thashë.

Siguria e Andresë, sjellja e saj e shpejtë dhe e saktë, më hutuan. Ajo më vështroi me dyshim:- Kjo vajza pranë meje më tha se ti je nxënësja më e mirë,- tha,- duke bërë me shenjë nga Lizeta, me një lëvizje të lehtë të kokës.- E vërtetë është?

- Dal shpesh e para,- thashë me modesti.

E përshkova Andrenë me shikim; flokët e saj të zinj e të drejtë i binin anash fytyrës, në mjekër kishte një njollë boje mavi. Nuk takohet çdo ditë dikush që është djegur nga flakët, doja t'i bëja shumë pyetje, por atëkohë hyri zonjusha Dybua, fustani i gjatë i fshinte dyshemenë; ishte grua e gjallë e me qime të gjata mustaqesh, për të cilën kisha shumë respekt. U ul dhe na thirri emrat; pastaj iu drejtua Andresë:- Atëherë, e dashur vajzë, mos po ndiheni pak e ndrojtur sot?

- Nuk jam e ndrojtur, zonjushë,- tha Andrea me zë të plotë; dhe shtoi më butë:- Sepse edhe ju nuk na shkaktoni drojë.

Zonjusha Dybua ngurroi një çast, pastaj buzëqeshi nën qimet e mustaqeve dhe vazhdoi apelin.

Mbarimi i mësimit mbyllej sipas një riti të pandryshueshëm; zonjusha Dybua qëndronte te pragu i derës, i shtrëngonte dorën secilës nënë dhe puthte në ballë të gjithë fëmijët. Andresë i vuri dorën në sup:- Nuk keni qenë asnjëherë në shkollë?

- Jo, kam mësuar në shtëpi, por tani u rrita ca si shumë.

- Shpresoj të ecni në gjurmët e motrës suaj më të madhe,- i tha zonjusha Dybua.

- Oh! Jemi shumë të ndryshme,- tha Andrea.- Maluja i ka ngjarë babit, asaj i pëlqen shumë matematika, ndërsa unë mbi të gjitha dua letërsinë.

Lizeta më gjuajti me bërryl; nuk mund të thuhej se Andrea ishte e pacipë, por nuk ishte kjo mënyra, me të cilën nuk mund t'i drejtoheshe mësueses.

- A e dini se ku ndodhet salla e studimit për nxënëset e ditës? Nëse nuk do të vijnë t'ju marrin shumë shpejt, mund të shkoni atje e të prisni,- tha zonjusha.

- Nuk do vijë njeri të më marrë, do të kthehem vetë,- tha Andrea dhe shtoi me vrull:- Mamaja e ka njoftuar shkollën.

- Vetëm?- pyeti zonjusha Dybua dhe mblodhi supet:- Por, përderisa nëna juaj ka njoftuar...

Më erdhi radha mua të më puthte në ballë, pastaj ndoqa pas Andrenë deri te gardëroba; ajo veshi pallton, më pak origjinale sesa imja, por shumë e bukur; prej leshi të trashë, e kuqe me kopsa ngjyrë ari; nuk ishte sigurisht një vajzë rruge, si e lejonin të ecte vetëm? Mos vallë nëna e saj nuk ia kishte idenë e rrezikut të bonboneve të helmuara dhe gjilpërave të infektuara?

- Ku banoni, Andre e dashur?- e pyeti mamaja ime, ndërkohë që zbrisnim shkallët me motrat e mia më të vogla.

- Në rrugën Grenelle.

- Ah, sa mirë! Do t'ju shoqërojmë deri te bulevardi Saint-Germain,- tha mamaja.- Se andej na bie rruga.

- Me kënaqësi,- tha Andrea,- por mos u shqetësoni për mua.

I hodhi mamasë një shikim serioz:- Zonjë, në familjen tonë jemi shtatë vëllezër e motra; mamaja ime thotë se duhet të mësohemi t'ia dalim vetë mbanë.

Mamaja tundi kokën, por dukej sheshit se nuk ishte në një mendje.

Kur dolëm në rrugë e pyeta Andrenë:- Po si ndodhi që u dogje?

- Po piqnim patate në një zjarr përjashta; më mori flakë fustani dhe e gjithë këmba e djathtë m'u dogj deri në kockë.

Andrea bëri një lëvizje të vogël padurimi, e mërziste kjo histori e vjetër.

- Kur do m'i japësh fletoret? Se dua të shoh çfarë keni mësuar gjatë vitit të kaluar.

Më thuaj ku e ke shtëpinë, se vij vetë sot pasdite; ose dhe nesër.

Shikova mamanë, për t'i marrë miratimin; te Kopshtet e Luksemburgut më ndalonin të luaja me vajza, të cilat nuk i njihja.

- Këtë javë nuk është e mundur,- tha mamaja, disi e bezdisur.- Ndoshta të shtunën.

- Mirë, po pres deri të shtunën,- tha Andrea.

E ndoqa me sy tek përshkoi bulevardin, me atë pallton prej leshi të kuq; ishte vërtet shumë e vockël, por ecte me sigurinë e një të rriture.

- Daja yt, Zhaku, njihte disa Galarë, të afërm me Lavernjët, kushërinjtë e Blansharëve,- tha mamaja me pamje të përhumbur.- Vras mendjen a është nga ajo familje. Por, mendoj se njerëzit për së mbari nuk e lënë një vajzë nëntë vjeçe të bredhë vetëm rrugëve.

Prindërit e mi diskutuan një copë herë të gjatë për degët e ndryshme të familjeve të ndryshme Galar, për të cilët kishin dëgjuar pak a shumë të flitej. Mamaja mori disa të dhëna nga mësueset. Prindërit e Andresë ishin kushërinj shumë të largët të Galarëve të dajë Zhakut, por me emër mjaft të mirë. Zoti Galar kishte studiuar te Politekniku, ishte rregulluar mirë te Citroëni dhe kryesonte Ligën e Etërve të familjeve të mëdha në numër; gruaja e tij, nga familja Rivierë de Bonëj i përkiste një dinastie të madhe katolikësh militantë dhe respektohej shumë nga famullitarët e Shën Thoma Akunit. E informuar, pa dyshim, për ngurrimet e sime mëje, zonja Galar erdhi vetë ta merrte Andrenë atë të shtunë, kur dolëm nga shkolla. Ishte grua e bukur, me sy të zinj, rreth qafës kishte një rrip të ngushtë prej kadifeje të zezë të kapur me një stoli antike; e bëri për vete mamanë time menjëherë, kur i tha se dukej sikur ishte motra ime e madhe dhe duke e thirrur “zonjës e re”. Ndërsa mua nuk më pëlqeu fare rripi i saj prej kadifeje.

Zonja Galar i tregoi gjithë emocion mamasë martirizimin e Andresë: mishin e përcëlluar, fluskat e mëdha, fashat e zverdheme, makthet e Andresë, guximin e saj; një djalë i vogël, duke luajtur, e goditi me shkelm padashur dhe i hapi plagët: ajo e mbajti veten aq shumë për të mos bërtitur, sa i ra të fikët. Kur erdhi në shtëpi për të parë fletoret e mia, unë e vështrova me respekt; ajo po mbante shënimet, me një shkrim të bukur e të formuar mirë dhe mua më shkonte mendja te kofsha e saj e ënjtur, poshtë fundit të shkurtër me pala. Kurrë nuk kisha hasur diçka kaq interesante. Befas pata përshtypjen se mua nuk më kishte ndodhur kurrë gjë prej gjëje.

Të gjithë fëmijët që njihja më mërzisnin; por Andrea, kur shëtisnim në oborrin e lojërave gjatë pushimit mes orëve të mësimi, më bënte për të qeshur; imitonte për mrekulli gjestet pa takt të zonjushës Dybua, zërin e butë të zonjushës Vondru, drejtoreshës; dinte, nga motra e saj më e madhe, një mori të fshehtash të asaj shkolle: zonjushat bënë pjesë në urdhrin e jezuitëve, flokët i krihnin me vizë anash sa kohë ishin ende rishtare dhe me vizën në mes, pasi bënë betimin. Zonjusha Dybua, e cila ishte vetëm tridhjetë vjeçe, qe më e reja

mes tyre: e kishte marrë diplomën një vit më parë, nxënëset më të rritura e kishin parë në Sorbonë, të përskuqur e të sikletosur me fundet që mbante. Ndihesha pak keq nga ky mosrespekt i Andresë, por ajo ishte kaq e lezetshme dhe unë ktheja përgjigjet, kur ajo shkërbente pikë për pikë një dialog midis mësueseve tona. Karikaturat e saj ishin kaq të vërteta sa shpesh gjatë mësimit ne i binim me bërryl njëra-tjetrës, kur zonjusha Dybua hapte regjistrin apo mbyllte librin; madje një herë mua më kapi një e qeshur e papërmbajtur sa me siguri do të më kishin nxjerrë përjashta nga klasa, por, nuk ndodhi, ngaqë sjellja ime e përgjithshme ishte shumë e virtytshme.

Herët e para që shkoja të luaja në shtëpinë e Andresë, shastisesha; përveç vëllezërve e motrave, aty, në rrugën Grenelle gjeja gjithnjë turma kushërinjsh e shoqesh e shokësh të vegjël; ata vraponin, thërrisnin, këndonin, loznin kukafshehthi, kërcenin sipër tryezave, rrëzonin mobilet; ndonjëherë ndërhynte Maluja, që ishte pesëmbëdhjetë vjeçe dhe që mbahej më të madh, por atëherë dëgjohej zëri i zonjës Galar: “Lëri fëmijët të lozin”. Habitesha nga shpërfillja e saj ndaj plagëve, xhungave, njollave, pjatave të thyera. “Mami nuk mërzitet kurrë”, më thoshte Andrea me një buzëqeshje triumfuese. Andej nga fundi i pasdites, zonja Galar hynte duke buzëqeshur në dhomën që ne kishim shkatërruar; ngrinte një karrige dhe qëndronte përballë Andresë: “Prapë qenke bërë qull në djersë!” Andrea e përqaftonte fort dhe për një çast fytyra e saj shpërfytyrohej: unë hiqja sytë me një ndjesi idhnake, ku përzihej pa dyshim xhelozia, ndoshta zilia dhe ajo lloj frike që të frymëzojnë misteret.

Mua më kishin mësuar se duhej t’i doja njësoj si mamanë ashtu dhe babain: Andrea nuk e fshihte që parapëlqente të ëmën ndaj të atit. “Babi është shumë serioz”, më tha një ditë krejt e qetë. Zoti Galar më hutonte, se nuk i ngjante asfare babait tim. Im atë nuk shkonte kurrë në meshë dhe buzëqeshte kur para tij përmendnin mrekullitë e Lourdesit; e kisha dëgjuar të thoshte se ai kishte vetëm një fe: dashurinë për Francën. Mungesa e tij e devocionit nuk më mërziste; mamasë, që ishte shumë fetare, i dukej normale kjo gjë; një burrë aq superior sa babai detyrimisht kishte marrëdhënie shumë më të ndërlikuara me Zotin sesa gratë dhe vajzat e vogla. Ndërsa zoti Galar kungohej çdo të diel me gjithë familjen, mbante mjekër të gjatë, binokël, dhe gjatë kohës së lirë merrej me veprimtari shoqërore. Në sytë e mi, ato flokët e tij të rregulluara me kujdes,

ato virtytet e tij të krishtera sikur e femërorizonin dhe e ulnin. Por, ai shihej vetëm në raste të rralla.

Ishte zonja Galar që e drejtonte shtëpinë. E kisha zili lirinë që i jepte Andresë; megjithatë, sado që ajo më sillej me dashamirësinë më të madhe, sepse nuk ndihesha mirë në praninë e saj.

Nganjëherë Andrea më thoshte: “U lodha nga këto lojërat”. Shkonim e uleshim në studion e zotit Galar, nuk ndiznim drita, që të mos na zbulonin dhe bisedonim me orë të tëra: ishte një kënaqësi e re. Prindërit e mi më flisnin dhe unë u flisja, por ne nuk bisedonim me njëri-tjetrin; me Andrenë bëja biseda të vërteta, si babai me mamanë, mbrëmjeve. Ajo kishte lexuar shumë libra, kur kishte qëndruar në shtëpi e sëmure; dhe më habiste, sepse dukej sikur u besonte historive të rrëfyera në libra: e urrente Horacin dhe Poliektin, adhuronte Don Kishotin dhe Sirano të Berzherakun, si të kishin ekzistuar me të vërtetë. Edhe për shekujt e shkuar ajo kishte pëlqimet e saj të patundura. I pëlqenin grekët, romakët e mërznisnin; ishte e pandjeshme ndaj fatkeqësive të Luigjit XVII dhe të familjes së tij, ndërsa vdekja e Napolonit e prekte thellë.

Shumë prej mendimeve të saj ishin acaruese, por, për shkak të moshës shumë të njomë, zonjushat e falnin. “Ka personalitet, ajo vajzë e vogël”, thoshin në kolegji.

Andrea e kapërceu shpejt vonesën në mësim, në lëndët letrare tashmë ia kaloja fare pak, ndërsa ajo pati nderin të hidhte dy nga hartimet e saj në librin e artë.

Luante aq mirë në piano, sa e futën menjëherë në kursin e ndërmjetëm; filloi të merrte edhe mësim në violinë. Nuk ia kishte ënda të qepte e të qëndiste, por i vinte ndoresh për çdo gjë; mbështillte bukur kamelet mou, biskotat sablés, çokollatat me tartuf; ndonëse e brishtë, dilte në krye kudo, bënte sparkatën dhe të gjitha llojet e akrobacive. Por, ajo që e lartësonte më shumë në sytë e mi ishin disa tipare të veçanta të karakterit të saj, të cilave nuk ua mora vesh kurrë kuptimin: kur pikaste një pjeshkë apo një orkide, ose kur thjesht i shqiptonin këto fjalë para saj, Andrea dridhej, i bëhej mishi si i pulës; aty shfaqej në mënyrën më turbulluese ajo dhunti që e kishte dhuratë nga qielli dhe që më mahniste: personaliteti. Fshehtazi mendoja se Andrea ishte me siguri një prej atyre fëmijëve të jashtëzakonshëm, jeta e të cilëve më vonë rrëfëhet nëpër libra.

* * *

Shumica e nxënëseve të kolegjit u larguan nga Parisi rreth mesit të korrikut për shkak të bombardimeve dhe të Bertës gjigante^[1].

Galarët u nisën për në Lourdes; çdo vit, ata merrnin pjesë në një pelegrinazh të madh; djali mbante barelat, vajzat më të rritura lanin enët bashkë me nënën në kuzhinat e një bujtine; mua më dukej e jashtëzakonshme që Andresë i besonin të tilla gjëra të rriturish, kështu e respektoja edhe më shumë. Por, isha edhe krenare për qëndrimin heroik të prindërve të mi: duke mos lëvizur nga Parisi, ne u tregonim ushtarëve tanë trima se edhe civilët “rezistonin”. Në klasë kisha mbetur vetëm unë dhe një vajzë dymbëdhjetëvjeçare, e vonuar mendërisht: u ndjeva e rëndësishme. Një mëngjes, sapo arrita në kolegji, i gjeta mësueset dhe nxënëset strukur në qilar: në shtëpi qeshëm paprerë me të madhe. Gjatë alarmeve, ne nuk zbrisnim poshtë në bodrum; banorët e kateve të sipërme vinin e strehoheshin te ne, flinin në kanapetë e paradhomës. Më pëlqente shumë e gjithë kjo gjendje e ethshme.

Në fund të korrikut, bashkë me mamanë dhe motrat, u nisëm për në Sadernac.

Gjyshi, të cilit i kujtohej rrethimi i vitit 1871, pandehte se ne në Paris ushqeheshim me minj: për dy muaj me radhë na gatoi pulë dhe tortë me qershi. Kalova ditë të lumtura. Në sallon ai kishte një bibliotekë plot me libra të vjetër, me faqe të ngrëna e të zverdhura; veprat e ndaluara ishin renditur në raftet e sipërme dhe mua më lejonin të shfletoja lirisht librat në raftet e poshtme. Lexoja, luaja me motrat, shëtisja. Atë verë brodha shumë. Ecja mes pyllit me gështenja duke gjakosur duart me gjethet e fierit, gjatë shtigjeve të hapura mbledhja tufa dorëzonjash dhe fshikakuqesh, shijojë manaferrat, frutat e luleshtrydheve, maretë, thanat, kokrrat e tharta të ferrave, thithja aromën valëvitëse të hikrrës në lulëzim, shtrihesha përtokë për të ndier duhmën e fshehtë të shqopës. Dhe pastaj ulesha te lëndina e madhe buzë plepave të argjendte dhe hapja një roman të Fenimor Kuperit. Kur frynte erë, plepat mërmërisnin. Era më dalldiste. Më dukej sikur pemët flisnin me njëra-tjetrën

dhe me Perëndinë nga një cep i tokës në tjetrin; ishte një muzikë dhe një lutje që ma përshkonte zemrën, para se të ngrihej lart në qiell.

Kënaqësitë e mia ishin të panumërta, por nuk i rrëfeja dot; i dërgova Andresë vetëm disa kartolina me pak fjalë; edhe ajo nuk më shkruante ndonjë gjë të madhe; ishte në Landes, te gjyshja nga ana e nënës, kalëronte, argëtohej pa masë; në Paris do të kthehej vetëm në mes të tetorit. Nuk mendoja dhe aq shpesh për të. Gjatë pushimeve, nuk mendoja pothuajse aspak për jetën time të Parisit.

I derdha ca lot kur u thashë lamtumirë plepave: po bëhesha sentimentale, sikur po rritesha. Por, në tren, u ndërmenda sa shumë më pëlqenin kthimet. Babai na priste në stacion veshur me uniformën e tij gri në bojëqielli, thoshte se lufta do të mbaronte së shpejti. Librat e mësimit dukeshin edhe më fringo të rinj se ata të vitit të kaluar: ishin më të trashë, më të bukur, kërcisnin nëpër gishta, vinin erë të mirë; në Kopshtet e Luksemburgut gjethet e thara dhe bari i djegur lëshonin një aromë mallëngjyese; zonjushat më përqaftuan me zjarr dhe m'i lëvduan me të madhe detyrat që kisha kryer gjatë pushimeve; por, përse atëherë ndihesha kaq e palumtur? Mbrëmjeve, pas darke, ulesha në paradhomë, lexoja ose shkruaja historira në një bllok; motrat flinin, në fund të korridorit babai i lexonte me zë të lartë nënës: ishte një nga momentet më të bukura të ditës. Ja ku rrija kruspull mbi moketin e kuq, pa bërë asgjë, e trallisur. Vështroja dollapin norman dhe sahatin prej druri të gdhendur që kishte brenda dy boçe pishe prej bakri bashkë me hijet e kohës; pas murit mbështetej radiatori me ajër të nxehtë, përmes grilës së tij të praruar mund të ndieje ngrohtësinë e një fryme trulllosëse që ngjitej nga thellësitë. Një mbrëmje, befas, i gjithë ai terr dhe ato gjëra memece përreth më futën frikën. Dëgjoja zërin e babait; e njihja titullin e librit: *Ese mbi pabarazinë e racave njerëzore*, shkruar nga konti i Gobinosë; vitin e mëparshëm lexonte *Origjinat e Francës së sotme*, shkruar nga Taine. Vitin tjetër do të fillonte një libër të ri dhe unë do isha përsëri atje, midis dollapit dhe sahatit të murit. Për sa vite? Sa mbrëmje? Kjo na qenkësh jeta: të shtyje ditët njëra pas tjetrës? Të më mbyste për vdekje mërzia? Thosha me vete se më mungonte Sadernacu; para se të bija të flija, i derdha dhe nja dy lot të tjerë për plepat.

Dy ditë më vonë, papritmas, e mësova arsyen e vërtetë. Po hyja në sallën Sainte-Catherine dhe Andrea më buzëqeshi; i buzëqesha dhe unë dhe i zgjata

dorën:- Kur je kthyer?

- Mbrëmë.

Andrea më shikoi disi tinëz:- Me siguri ke qenë këtu që ditën e parë?

- Po,- thashë.- I kalove mirë pushimet?

- Shumë mirë, po ti?

- Shumë mirë.

Po thoshim gjëra pa rëndësi, si të rriturit; por shpejt e kuptova, me habi dhe me gëzim, se boshllëku që kisha në shpirt, shija e zymtë e ditëve të mia kishin veç një shkak: mungesën e Andresë. Jeta pa atë nuk ishte jetë. Zonjusha Dë Vilënevë u ul te tryeza e saj dhe unë përsërita me vete: “Pa Andrenë, nuk jetoj dot më”. Gëzimi m’u shndërrua në ankth: po atëherë, pyeta veten, si do më vejë filli, sikur ajo të vdesë? Unë do të isha e ulur te stoli, do të hynte drejtoresha dhe do të fliste me një ton të rëndë në zë: “Le të lutemi, fëmijët e mi, për shoqen tuaj të vogël Andre Galar, të cilën Zoti e thirri mbrëmë pranë tij.” Po mirë, shumë e thjeshtë, vendosa, do të rrëshqisja poshtë nga stoli e do të vdisja dhe unë. Kjo ide nuk më trembte, sepse e dija që kishim për t’u takuar shumë shpejt para dyerve të parajsës.

Më 11 nëntor festuam armëpushimin, njerëzit përqafoheshin në rrugë. Isha lutur katër vjet të mbërrinte kjo ditë e madhe dhe prisja ndryshime të hatashme; më riktheheshin në mendje kujtime të mjegullta. Babai veshi përsëri rrobat civile, por asgjë tjetër nuk ndodhi; ai fliste pa pushim për njëfarë kapitali, të cilin ia kishin plaçkitur bolshevikët; ata njerëz të largët, emri i të cilëve i përngjante rrezikshëm atij të boshëve, siç i thërrisnim me përçmim gjermanët, me sa dukej zotëronin fuqi të tmerrshme. Pastaj gjenerali Foch e kishte lënë veten të manovrohej: duhej të kishte shkuar deri në Berlin. Babai e shihte aq të vështirë të ardhmen, sa nuk guxoi ta hapte zyrën e sipërmarrjes së tij; gjeti një punë në një agjenci sigurimesh, por njoftoi se duhej të ulnim nivelin e jetesës. Mamaja e hoqi Elizën, e cila gjithsesi sillej keq e dilte mbrëmjeve me punëtorët e zjarrfikëseve; ajo i mori vetë përsipër të gjitha punët e shtëpisë; mbrëmjeve nuk i qeshte buza, as babait; motrat e mia qanin shpesh. Sa për mua, nuk qahesha fare, unë kisha Andrenë.

Andrea po rritej dhe po forcohej; nuk mendoja më se mund të vdiste; por një tjetër rrezik po më kërcënonte: kolegji nuk e shihte me sy të mirë miqësinë tonë. Andrea ishte nxënëse e shkëlqyer, unë e mbaja akoma vendin e parë

vetëm sepse ajo nuk denjonte ta zinte; e adhuroja moskokëçarjen e saj, por nuk isha e zonja të bëja të njëjtën gjë. Megjithatë, ajo e kishte humbur mbështetjen e mësueseve. E gjykonin si të çuditshme, ironike, sedërmadhe, e qortonin se tallej e përqeshte shoqet; nuk ia dilnin dot kurrë mbanë ta kapnin duke kryer krimin e fyerjes, sepse Andrea kujdesej t'u rrinte larg dhe ndoshta pikërisht për këtë arsye ato acaroheshin edhe më shumë. Arritën diçka ditën e saxhos së pianos. Salla e festave ishte mbushur plot e përplot: në radhët e para, nxënëset e veshura me fustanet e tyre më të bukura, me flokët me bukla, kaçurrela, mbledhur topuz; pas tyre mësueset dhe kujdestaret, me bluza mëndafshi, me doreza të bardha; në fund prindërit dhe të ftuarit e tyre.

Andrea, ngjeshur brenda një fustani blu prej taftaje, luajti një pjesë që nënës së saj i dukej shumë e vështirë për të dhe ku zakonisht ajo gabonte disa masa; u drithërova kur pashë gjithë ato vështrime pak a shumë keqdashëse ta shigjetonin në kohën kur po arrinte te pjesa e zorshme; ajo e luajti pa as më të voglin gabim dhe, duke i hedhur së ëmës një vështrim triumfues, i nxori gjuhën. Vajzat u drodhën të gjitha poshtë buklave; disa nëna u kollitën të skandalizuara, mësueset shikuan njëra-tjetrën, drejtoresha u bë flakë në fytyrë. Kur Andrea zbriti nga podiumi, vrapoi drejt së ëmës, e cila e përqafoi duke qeshur me gjithë zemër, sa zonjusha Dë Vilënevë nuk pati zemër ta qortonte. Por, disa ditë më vonë, ajo iu ankua mamasë sime për ndikimin e keq që Andrea ushtronte mbi mua: ne fjaloseshim gjatë orës së mësimit, unë tallesha, shpërqendrohesha; ngulmoi të na ndante gjatë mësimëve dhe unë kalova një javë në ankth. Zonja Galar, që e vlerësonte zellin tim për mësimet, e bindi lehtë mamanë time të na linin të qeta dhe, meqenëse ato ishin kliente të shkëlqyera dhe ime më kishte tri vajza, zonja Galar gjashtë dhe shumë lidhje miqësore, ne vazhduam të rrinim ulur pranë njëra-tjetrës si më parë.

Do të brengosej Andrea, nëse do të na ndalonin të shiheshim? Më pak sesa unë, pa dyshim. Tanimë na quanin dy të pandarat dhe ajo donte të rrinte me mua më shumë sesa me të tjerat. Por mua më dukej se adhurimi që ajo kishte për të ëmën ia zbehte ndjenjat e tjera. Familja e saj ishte e para për të; kalonte shumë kohë duke luajtur me dy binjaket e vogla, i lante, i vishte ato masa mishi të hallakatura; u gjente kuptim belbëzimeve, mimikës së tyre të pasigurt, i ledhatonte me dashuri. E pastaj ishte muzika, që zinte shumë vend në jetën e saj. Kur ulej në piano, kur vendoste violinën rrëzë qafës dhe dëgjonte me një

prehje shpirtërore melodinë që dilte nga ata gishtërinj, më dukej sikur fliste me veten: pas këtij dialogu të gjatë, që i vazhdonte fshehtësisht thellë në zemër, bisedat tona më ngjanin tepër fëmijërore. Ndonjëherë zonja Galar, që i binte pianos në mënyrë të përsosur, e shoqëronte Andrenë ndërsa luante me violinë dhe atëherë mua më dukej vetja krejt e përjashtuar. Jo, miqësia jonë nuk kishte të njëjtën rëndësi për Andrenë siç kishte për mua, por unë e admiroja aq shumë, sa nuk e vuaja.

Vitin tjetër prindërit e mi e lanë apartamentin në bulevardin Montparnasse dhe u zhvendosën në rrugën Casette, në një banesë shumë të vogël, ku unë nuk gjeja dot asnjë qoshe për veten time. Andrea më tha se mund të shkoja e të mësoja tek ajo, kur të doja. Çdo herë që hyja në dhomën e saj, emocionohesha aq shumë sa më vinte të bëja kryqin. Përsipër shtratit ishte një kryq i drunjtë me Krishtin e kryqëzuar, përballë një shenjtoje, Ana, e Leonardo da Vinçit; përmbi oxhak një portret i zonjës Galar dhe një fotografi e vilës në Béthary; përmbi rafte, biblioteka personale e Andresë: Don Kishoti, Udhëtimet e Guliverit, Evgjëni Grandé, romani Tristani dhe Izolda, pjesë të të cilit ajo i dinte përmendësh; zakonisht i pëlqenin librat realistë apo satirikë: magjepsja pas kësaj epopeje dashurore, më turbullonte pak. Pyesja me angështi muret dhe objektet që rrethonin Andrenë. Doja të kuptoja atë që thoshte, kur përshkonte me hark kordat e violinës. Doja të dija përse ajo, që kishte aq dashuri në zemër, aq dhunti, që dinte dhe bënte aq shumë gjëra, shpesh dukej e përhumur dhe melankolike. Ishte shumë besimtare. Kur shkoja të lutesha në kapelë, e gjeja jo rrallë në gjunjë buzë altarit, me kokën në duar ose me krahët zgjatur para një skene të Udhës së Kryqit. Mos donte t'i përkushtohej fesë më vonë? Por ajo e donte lirinë e saj dhe gëzimet e kësaj bote. Kur më rrëfente për pushimet, i shkëlqenin sytë: kalëronte me orë të tëra mespërmes pyjeve të pishave, degët e ulëta të të cilave i gërvishtnin fytyrën, notonte në ujërat e qeta të liqentheve dhe në ujërat e rrëmbyera të Adourit. Ishte kjo parajsë që ëndërronte, kur qëndronte pa lëvizur përpara librave e me shikim të humbur? Një ditë e pikasi që po e vëzhgoja dhe qeshi me hutim:- Të duket se po humbas kohën kot?

- Unë? Aspak!

Andrea më vështroi me ngacmim:- Nuk të ndodh asnjëherë të ëndërrosh me sy hapur?

- Jo,- thashë me përlësi.

Për çfarë të ëndërroja? Mbi gjithçka tjetër unë doja Andrenë dhe ajo ishte aty, pranë meje. Nuk ëndërroja, mësoja mirë mësimet, më tërhiqte dhe isha kureshtare për gjithçka; Andrea më vinte shpesh në lojë; përgjithësisht ajo i vinte në lojë të gjithë; i pranoja me humor talljet e saj. Megjithëse, një herë, më lëndoi thellë. Atë vit, jo si përherë, i kalova Pashkët në Sadernac. Po zbuloja pranverën dhe isha verbuar e gjitha. Një ditë u ula te një tavolinë në kopsht, përpara një flete të bardhë dhe për dy orë me radhë i përshkrova Andresë barin e sapombirë ku ngrinin krye agulicet dhe vjollcat, aromën e lulevileve, kaltërsinë e qiellit dhe shkumat e forta të shpirtit.

Ajo nuk m'u përgjigj. Kur e takova në gardërobën e kolegjit, e pyeta hatërbetur:

- Përse nuk më shkrove? A e more letrën time?

- E mora,- tha Andrea.

- Qenke një përtace e keqe, atëherë!- i thashë.

Andrea filloi të qeshte:- Pandeja se më kishe dërguar gabimisht një detyrë nga ato të pushimeve...

Ndjeva se po skuqesha:- Një detyrë?

- Mos bëj kot, nuk e kishe sajuar gjithë atë punim letrar vetëm për mua!- tha Andrea.- Jam e bindur që ishte kopja e keqe e ndonjë hartimi me titull: "Përshkruani pranverën".

- Jo,- thashë.- Ndoshta ishte letërsi e dobët, por ajo ishte një letër që e shkrova vetëm për ty.

U afruan motrat e vogla Bular, kureshtare dhe llafazane, dhe e lamë në mes bisedën. Por, në klasë u bëra lëmsh në orën e latinishtes.

Andresë i ishte dukur qesharake letra ime, kjo më theri në zemër; por, kryesorja, asaj as që i shkonte nëpër mend se sa nevojë kisha unë të ndaja gjithçka me të; kjo gjë më trishtonte më shumë: kuptova se ajo nuk ua kishte asfajë idenë ndjenjave që ushqejta ndaj saj.

Dolëm bashkë nga kolegji; tani nuk më shoqëronte më mamaja dhe zakonisht kthehesha me Andrenë; befaj ajo më kapi nga bërryli: ishte një gjest i pazakontë, ne gjithnjë ruanim njëfarë distance.

- Silvi, më vjen keq për ato që të thashë pak më parë,- tha, e ngashëryer:- u solla shumë keq, se e di shumë mirë që letra jote nuk ishte detyrë pushimesh.

- Ma ha mendja se ishte qesharake,- thashë.

- Aspak! E vërteta është se ditën kur e mora, isha në humor të keq, ndërsa ti dukesh aq festive!

- Po pse, pse ishe e mërzitur?- e pyeta.

Andrea heshti një grimë.- Ashtu, kot, për asgjë; për gjithçka.

Pastaj foli, me ngurrim:- Jam lodhur duke qenë fëmijë, - tha me vrull.- A nuk të duket se fëmijëria nuk mbaron kurrë?

E vështrova me habi; Andrea ishte shumë më e lirë sesa unë; ndërsa unë, megjithëse në shtëpi nuk frynte erë gëzimi, nuk doja aspak të rritesha. Ideja se kisha mbushur trembëdhjetë vjeçe, më tmerronte.

- Jo,- thashë.- Jeta e të rriturve më duket shumë monotone; të gjitha ditët njësoj, nuk mëson më asgjë...

- Ah! Se vetëm mësimet kanë rëndësi në këtë jetë,- tha Andrea me padurim.

Desha ta kundërshtoja: "Nuk janë vetëm mësimet për mua, je dhe ti". Por, tashmë kishim ndryshuar temë. Thosha me vete me hidhërim: nëpër libra njerëzit bëjnë deklarata dashurie, urrejtjeje, guxojnë e tregojnë çdo gjë për të cilën u dridhet zemra; përse është kaq e pamundur në jetë? Do të ecja dy ditë e dy net pa ngrënë e pa pirë asgjë, vetëm e vetëm të shihja një orë Andrenë ose për t'i lehtësuar një dhimbje: dhe ajo nuk e kupton asfare!

I blova këto mendime të trishta për disa ditë me radhë, pastaj më erdhi një përndritje: do t'i bëja Andresë një dhuratë për ditëlindje.

Prindërit janë të paparashikueshëm; zakonisht, nismat e mia mamasë i dukeshin që në krye të pakuptimita; por ideja e dhuratës, kësaj here, u pranua. Duke u nisur nga një model në letër i La Mode pratique, vendosa të bëja një çantë dore që do të ishte kulmi i luksit. Zgjodha një mëndafsh me ngjyra të kuqe dhe blu, brokadë e qëndisur me fije ari, e plotë dhe farfuritëse, që mua më dukej e bukur si përrallë. E vendosa në një skelet prej kashte, që e thura vetë. Nuk më pëlqente fare të qepja, por, iu futa punës me aq zell, sa kur e mbarova, çanta e vogël e dorës dukej shumë e bukur me astarin prej sateni ngjyrë qershie e me mbylljen me kërcitje. E mbështolla me letër mëndafshi dhe e futa në një kuti kartoni, që e lidha me fjongo.

Ditën kur Andrea mbushi trembëdhjetë vjeçe, mamaja erdhi me mua te festa e ditëlindjes; kishte shumë njerëz dhe mua më erdhi shumë zor kur i dhashë Andresë kutinë e kartonit:- Për ditëlindjen tënde,- i thashë.

Ajo më vështroi me habi dhe unë shtova:- E kam bërë me duart e mia.

Ajo hapi çantën e vogël vezulluese dhe faqet iu bënë purpur:- Silvi! Po kjo është një mrekulli! Sa e mirë që je!

Mendova se, sikur nënat tona të mos ishin aty, ajo do të më ishte hedhur në qafë.

- Duhet të falënderosh edhe zonjën Lëpazh,- i tha zonja Galar me zërin e saj të ngrohtë.- Sepse, pa dyshim, ajo është munduar më së shumti...

- Faleminderit, zonjë,- u përgjigj shkurt Andrea. Dhe më buzëqeshi përsëri, e mallëngjyer. Ndërkohë që mamaja ime tha me gjysmë zëri nja dy fjalë kundërshtuese, mua m'u mblodh një lëmsh në fyt. E kuptova se zonja Galar nuk më donte më.

* * *

Sot e admiroj shkathtësinë e asaj gruaje vigjilente: e vërteta është se unë po ndryshoja. Mësueset po më dukeshin tepër idiote, argëtohesha duke iu bërë pyetje që i vinin në vështirësi, i kundërshtoja dhe, kur më bënë vërejtje, i dëgjoja pa më ardhur turp. Ime më më qortonte nga pak, ndërsa babai qeshte, kur i tregoja për grindjet me zonjushat; ai gaz i tij më lehtësonte nga gjithçka; nga ana tjetër, as që më shkonte në mendje se Perëndia mund të fyhej njëfarësoj nga tekat e mia fëmijërore. Kur rrëfeshja, nuk më vinte zor prej çapkëllëqeve që numëroja. Unë rrëfeshja disa herë në javë dhe abati Dominik më shtynte në shtigjet e kundërimit mistik: jeta ime jobesimtare nuk kishte aspak lidhje me këtë aventurë të fshehtë. Mëkatet që ia numëroja vetes, kishin të bënin kryesisht me gjendjen time shpirtërore: më mungonte entuziazmi, e kisha harruar shumë gjatë praninë hyjnore, lutesha pa u përqendruar, isha shumë e vetëkënaqur. Një ditë, sapo kisha mbaruar së rendituri këto paudhësi të mia të vogla, kur, përmes vrimës së syrit të deriçka e rrëfyestores, dëgjoja zërin e abatit Dominik:- Kjo ishte e gjitha?

Shtanga në vend.

- Më kishin thënë se Silvia ime e vogël ka disa kohë që nuk është më ajo e para,- tha zëri.- Se është e padisiplinuar, e pabindur, e pasjellshme.

U skuqa e tëra në fytyrë dhe nuk arrita të nxirrja një fjalë nga goja.

- Që nga sot, duhet të jesh e kujdesshme,- vazhdoi zëri. - Po do të flasim.

Abati Dominik më çliroi nga mëkatet dhe unë dola nga rrëfyestorja me kokën zjarr; ika me vrap nga kapela, pa e bërë pendesën. Ndihesha edhe më e tronditur sesa një ditë në metro, kur një burrë hapi pardesynë e më tregoi një gjë ngjyrë rozë.

Tetë vjet me radhë kisha rënë në gjunjë para abatit Dominik si të gjunjëzohesha para vetë Zotit: por, ai na qenkësh një plak ngatërrestar, që dërdëlliste me zonjushat dhe i merrte seriozisht thashethemet e tyre. Tani më vinte turp që i kisha hapur zemrën: ai më kishte tradhtuar. Pas kësaj, kur pikasja veladonin e tij të zi nëpër korridore, skuqesha dhe largohesha me nxitim.

Gjatë fundvitit dhe vitit në vazhdim, shkoja për t'u rrëfyer te famullitarët e Shën Sulpicit; i ndërroja shpesh. Vazhdoja të lutesha e të meditoja, por gjatë pushimeve, nisa të shoh më qartë. E doja si përherë Sadernakun dhe, si dikur, aty shëtisja paprerë; por, tani maretë dhe lajthitë e kaçubave më ishin mërzitur, më shumë doja të shijoja qumështin e lule qumështoreve, të kafshoja ato kokrra të helmatisura në ngjyrë ndryshku dhe që mbajnë emrin e bukur dhe enigmatik të vulës së Solomonit. Bëja shumë gjëra të ndaluara: haja mollë mes vakteve, merrja fshehurazi romanet e Aleksandër Dymasë në raftet e sipërme të bibliotekës; bëja biseda udhëzuese për misterin e lindjeve me vajzën e gjymëtarit; natën, në shtrat, rrëfeja me vete histori të çuditshme që më krijonin gjendje po të çuditshme shpirtërore. Një mbrëmje, shtrirë mbi barin e lagësht, me hënën përsipër kokës, mendova: “Këto janë mëkate!”, megjithatë isha e krejtësisht e vendosur se do të vazhdoja të haja, të lexoja, të bisedoja e të ndërroja si të dëshiroja. “Unë nuk besoj në Zot!” thashë me vete. E si mund të besosh në Zot e pastaj të vendosësh se nuk do t'i bindesh? Shtanga një çast, e tronditur nga ky fakt: unë nuk besoja.

As babai, as shkrimtarët që admiroja nuk besonin; pa dyshim, bota nuk shpjegohej dot pa Perëndinë, por Perëndia nuk shpjegonte ndonjë gjë të madhe, as nuk kuptohej kushedi se çfarë në atë shpjegim. U mësova menjëherë me këtë gjendjen time të re. Gjithsesi, kur u ktheva në Paris, më pushtoi paniku. Nuk mund të mos e mendosh atë që mendon: por babai dikur thoshte se disfatistët duheshin pushkatuar dhe, një vit më parë, një nxënëse të një klase më lart e kishin përzënë nga kolegji, sepse, siç pëshpëritej, ajo kishte humbur

besimin. Më duhej ta fshihja me kujdes fatkeqësinë time; netëve, zgjohesha e mbytur në djersë nga mendimi se Andrea mund të dyshonte.

Për fat të mirë, ne pothuajse nuk flisnim kurrë për fenë apo për seksualitetin. Asokohe na shqetësonin shumë probleme të tjera. Studionim Revolucionin francez; admironim Camille Desmoulinsin, Madame Rolandin, madje dhe Dantonin. Diskutonim me orë të tëra për drejtësinë, barazinë, për të drejtën e pronës. Mendimi i mësueseve tona rreth këtyre çështjeve vlente më pak se zeroja, ndërsa prindërit tanë kishin ide të prapambetura, që nuk na e mbushnin më mendjen. Im atë lexonte me etje *Action française*. Zoti Galar ishte më demokrat, në rini të tij tërhiqej nga Marc Sangnier; por tani nuk ishte më i ri dhe i shpjegonte Andresë se socializmi nënkupton detyrimisht një barazi në nivel të ulët dhe duke mohuar vlerat shpirtërore. Nuk na bindte, por disa prej argumenteve të tij na shqetësonin. Ishim përpjekur të diskutonim me shoqet e Malusë, vajza më të rritura, që duhej të dinin shumë më tepër sesa ne; por ato mendonin si zoti Galar dhe nuk u interesonin të tilla çështje. U pëlqente më tepër të flisnin për muzikën, letërsinë, edhe për këto në mënyrë shumë sipërfaqësore. Maluja na kërkonte shpesh, kur priste mysafirë, që të shkonim e të shërbenim çajin, por e ndiente që ne nuk ushqenim ndonjëfarë respekti për të ftuarat e saj dhe, për kundërvënie, i mbahej më të madh Andresë. Një pasdite, Izabelë Barriera, e cila kishte rënë marrëzisht në dashuri me profesorin e saj të pianos, burrë i martuar e me tre fëmijë, nisi të fliste rreth romaneve me dashuri; njëra pas tjetrës, Maluja, kushërira Gitë dhe motrat Goselën shprehën dhe ato parapëlqimet e tyre.

- Po ti, Andre?- e pyeti Izabela.

- Mua më mërzhitin romanet me dashuri,- u përgjigj Andrea prerë.

- Oh, e pamundur!- tha Maluja.- E dinë të gjithë se ti e ke mësuar përmendësh *Tristanin dhe Izoldën*.

Dhe shtoi se atë nuk e tërhiqte aspak ajo histori; Izabela, përkundrazi, e donte; ajo tha si duke ëndërruar se ajo epike dashurore platonike, i dukej shumë emocionuese. Andrea ia plasi gazit:- Platonike, dashuria e Tristanit dhe Izoldës? Jo,- shtoi.- Aty nuk ka asgjë platonike.

Ra një heshtje e bezdisshme dhe pastaj Gita foli ftohtë: - Vajzat e vogla nuk duhet të flasin për gjëra të cilat nuk i kuptojnë.

Andrea qeshi përsëri dhe nuk iu përgjigj. Unë e vështrova e hutuar. Çfarë kishte dashur të thoshte në të vërtetë? Sa për vete, unë njihja vetëm një lloj dashurie: atë që provoja për të.

- E gjora Izabelë!- tha Andrea, kur më në fund shkua në dhomën e saj.- Duhet ta harrojë atë Tristanin e vet: gati është fejuar me atë tullacin e shpifur.- Pastaj tha me të qeshur:

- Shpresoj që të besojë te goditja e rrufeshme e shenjtëruar.

- Çfarë është kjo gjë?

- Luiza, tezja ime, mamaja e Gitës, ngul këmbë se në momentin kur dy të fejuarit shqiptojnë po-në e shenjtë, goditen rrufeshëm nga dashuria. E kupton, kjo teori i qetëson nënat; nuk është nevoja të shqetësohen për ndjenjat e bijave: merret Zoti me to.

- Nuk ma ha mendja se e beson njeri këtë,- thashë.

- Gita e beson.

Andrea heshti pak:- Mamaja ime nuk arrin deri aty, sigurisht,- foli pastaj:- por thotë se, pasi martohemi, na vijnë disa ndjenja të bukura.

Dhe shikoi portretin e së ëmës:

- Mamaja ka qenë shumë e lumtur me babin,- tha, disi e lëkundur:- por, ajo nuk do të ishte martuar me të, sikur të mos e detyronte gjyshja. E ka refuzuar dy herë.

Vështrova fotografinë e zonjës Galar: e çuditshme të përfytyroje se dikur ajo kishte pasur një zemër prej vajze të re.

- E ka refuzuar!

- Po. Babai i dukej shumë i ashpër. Ai e donte dhe nuk hoqi dorë. Gjatë fejesës filloi ta donte edhe ajo,- shtoi Andrea, por jo dhe aq e bindur.

Heshtëm disa çaste, duke u menduar.

- Nuk duhet të jetë gjë e këndshme të jetosh nga mëngjesi në mbrëmje me dikë që nuk e do,- thashë.

- Duhet të jetë e tmerrshme,- tha Andrea.

Ajo u drodh, sikur të kishte parë befaz një orkide dhe i shkuan mornica nëpër krahë.

- Në katekizëm na mësojnë se duhet ta respektojmë trupin tonë; por ta shesësh atë në një martesë, është po aq gjë e keqe si ta shesësh edhe jashtë saj,- tha.

- Nuk jemi të detyruara të martohemi,- thashë.

- Unë do të martohem,- tha Andrea.- Por jo para se të mbush njëzet e dy vjeçe.

Dhe hodhi me vrull mbi tryezë antologjinë e teksteve latine.- Bëjmë detyrat tani?- tha.

Iu ula pranë dhe u zhytëm në përkthimin e betejës së Trasimenës.

Nuk vajtëm më t'u shërbenim çajin shoqeve të Malusë. Pyetjeve që na vlonin në kokë, duhet t'ua gjenim vetë përgjigjen. Asnjëherë më parë nuk kishim diskutuar si atë vit. Dhe, pavarësisht të fshehtës sime që nuk i tregoja, kurrë nuk kishim qenë kaq afër njëra-tjetrës. Na linin të shkonim së bashku në Odeon, për të parë veprat e klasikëve. Aty zbuluam letërsinë romantike: unë marrosesha pas Hygoit, Andresë i pëlqente Myseja, po të dyja adhuronim Vinjinë. Filluam dhe të bënim projekte për të ardhmen. Për mua dihej, pasi të merrja maturën, do të vazhdoja studimet; Andrea shpresonte ta lejonin të ndiqte leksionet në Sorbonë. Në fund të tremestrit, unë pata gëzimin më të madh të fëmijërisë sime: papritur e pa kujtuar zonja Galar më ftoi të kaloja dy javë në Béthary dhe mamaja më lejoi.

Pandehja se Andrea do të dilte të më priste në stacion; por, kur zbrita nga treni u habita tek pashë përpara meje zonjën Galar. Ishte veshur me një fustan të zi me të bardhë, në kokë një kapelë prej kashte në ngjyrë të zezë, zbukuruar me margarita, shall taftaje të bardhë rreth qafe. Më afroi buzët te balli, por pa ma prekur.

- Mirë të shkoi udhëtimi, Silvi e dashur?

- Shumë mirë, zonjë, por druaj se jam krejt e ndotur me blozë,- u përgjigja.

Në prani të zonjës Galar nuk e di përse ndihesha gjithnjë paksa në faj; duart i kisha të zeza e, me siguri, të tillë duhej ta kisha dhe fytyrën; por ajo nuk po i kushtonte vëmendje; dukej e shpërqendruar; i buzëqeshi mekanikisht punonjësit të hekurudhës dhe shkoi drejt një kaloshini, e cila tërhiqej nga një kalë qimekaf; zgjidhi frerët e lidhur te një shtyllë dhe u ngjit me shkathtësi në karrocë.

- Eja!

Iu ula pranë; frenat luhateshin të lehta në duart e saj veshur me doreza.

- Doja të bisedoja diçka me ty, përpara se të takohesh me Andrenë,- tha, pa më vështruar.

Unë ngriva. Çfarë këshillash donte të më jepte? Mos vallë kishte zbuluar se nuk besoja më në Zot? Por, atëherë, përse më ftoi?

- Andrea ka disa probleme dhe unë kam nevojë për ndihmën tënde.

Unë përsërita si idiote fjalët e saj:- Andre ka probleme?

Nuk ndihesha mirë që zonja Galar po më drejtohej si të isha e rritur; në gjithë sjelljen e saj, kishte diçka të dyshimtë. Tërhoqi frerët dhe kërciti gjuhën; kali u nis me trok të lehtë.

- Të ka folur ndonjëherë Andrea për shokun e saj, Bernardin?

- Jo.

Kaloshini hyri në një rrugë me pluhur, me akacie në të dyja anët. Zonja Galar heshtte.

- I ati i Bernardit është pronar i pronës në kufi të asaj të nënës sime,- foli ajo, më në fund.- Rrjedh nga ato familjet baske që kanë emigruar në Argjentinë e kanë bërë pasuri. Ai jeton atje shumicën e kohës, bashkë me të shoqen dhe fëmijët e tjerë. Por, Bernardi është i brishtë, nuk i priu shëndeti në klimën e atjeshme; e ka kaluar këtu të gjithë fëmijërinë, me një hallë të moshuar dhe me mësuesit e caktuar për të.

Zonja Galar u kthye e më vështroi:

- Ti e di se pas aksidentit Andrea qëndroi një vit në Béthary, e shtrirë në një shtrat të fortë prej druri; Bernardi vinte dhe luante me të çdo ditë; ajo ishte vetëm, vuante, mërzhitej dhe, për moshën që kishin kjo nuk kishte rëndësi,- shtoi me një ton shfajësues, që më pështjelloi.

- Andrea nuk më ka treguar ndonjëherë për këtë,- thashë.

Në grykë m'u mblodh një lëmsh. Më vinte të zbrisja nga kaloshini dhe t'ia mbathja me vrap, si atë ditë kur ika nga sytë këmbët nga rrëfyestorja e abatit Dominik.

- Ata shiheshin çdo verë, kalëronin së bashku. Ishin ende fëmijë. Por, tani janë të rritur.- Zonja Galar kërkoi vështrimin tim; sytë e saj sikur më luteshin për diçka:- Shiko, Silvi, as që bëhet fjalë që Andrea dhe Bernardi të martohen një ditë; edhe i ati i Bernardit, si edhe ne, është krejtësisht kundër kësaj ideje. Prandaj, ia kam ndaluar Andresë që ta takojë.

Unë thashë nëpër dhëmbë me zë të ulët:- E kuptoj.

- Andrea e ka marrë shumë keq këtë punë,- tha zonja Galar. E më hodhi përsëri atë shikimin dyshimtar e lutës njëherazi.- Kam shumë besim te ti.

- Po unë, çfarë mund të bëj?- e pyeta.

Më dilnin nga goja fjalë pa pikë kuptimi dhe nuk arrija të kuptoja as ato që më hynin në veshë; koka më buçiste nga zhurmat dhe filloi të më errësohej si natë.

- Hiqja mendjen, foli për gjëra që i interesojnë. Dhe pastaj, nëse krijohet mundësia, ndihmoje të arsyetojë. Kam frikë se mos sëmuret. Në këtë moment, nuk i them dot asgjë,- shtoi zonja Galar.

Dukej qartazi se ishte shumë e shqetësuar dhe fatkeqe, por mua nuk më preku: përkundrazi, në atë çast e urreva. Pëshpërita me zor:

- Do të përpiqem.

Kali eci me trok të lehtë nëpër një rrugë me lisa të kuq anash dhe ndali përpara një vile të madhe me mure të mbuluara me hedera po të kuqe: e kisha parë në një fotografi mbi oxhakun e Andresë. Tani e kuptoja përse i donte kaq shumë Bétharynë dhe shëtitet me kalë; tani e dija se çfarë mendonte, kur vështrimi i vishej si me vel.

- Mirëmbërëma!

Andrea zbriti duke buzëqeshur shkallët e hyrjes. Ishte veshur me një fustan të bardhë me rrip të gjelbër, flokët e prerë shkurt i shndrisnin si helmetë; dukej vërtet si një vajzë e re dhe befas mendova se ajo ishte shumë e bukur: ishte një ide e pavend, sepse ne nuk i jepnim rëndësi bukurisë.

- Mendoj se Silvia ka nevojë të çlodhet e të marrë pak veten; pastaj zbrisni për darkë,- tha zonja Galar.

I shkova pas Andresë nëpër një korridor që vinte erë krem karameli, dylli të freskët dhe hambari të vjetër; pëllumbat gugatnin, dikush po luante në piano. Ngjitëm shkallët, Andrea shtyu një derë:- Mamaja të ka vënë në dhomën time,- tha.

Aty kishte një shtrat të madh me baldakin, me kolona të përdredhura dhe në qoshen tjetër të dhomës ndodhej një divan i ngushtë. Sa e lumtur do të isha, vetëm një orë më parë, nga ideja se do të flija në një dhomë me Andrenë! Por tani po hyja aty me një lëmsh në zemër; zonja Galar po më përdorte: një mënyrë për të kërkuar falje? Për të argëtuar Andrenë? Për ta kontrolluar? Nga çfarë kishte frikë?

Andrea iu afrua dritares:- Kur është kohë e kthjellët, prej këndeje mund të shihen Pirenetë,- tha, me shpërfillje.

Po ngrysej, koha nuk ishte e kthjellët. Shpëlava fytyrën, u kreha duke i treguar gjysma-gjysma se si më kishte shkuar udhëtimi. Për herë të parë, kisha hipur vetëm në një tren, kishte qenë një aventurë e vërtetë, por tani nuk më vinin fjalët e nuk dija çfarë t'i thosha.

- Duhet të presësh flokët,- tha Andrea.

- Mamasë nuk i pëlqen,- thashë.

Mamaja ime mendonte se flokët e shkurtër nuk bënë përshtypje të mirë; i lidha fort bisht pas qafe.

- Zbresim poshtë, të të tregoj bibliotekën,- tha Andrea.

Në piano ai dikushi vazhdonte të luante, dëgjoheshin disa fëmijë që këndonin; shtëpia ishte plot me zhurma enësh, zhurma hapash. Hyra në bibliotekë: koleksioni i plotë i *Revue des Deux Mondes*, që nga numri i parë, veprat e Louis Veuillotit, ato të Montalembertit, predikimet e priftit Lacordaire, diskutimet e Kontit de Mund, gjithçka nga Joseph de Maistre; përmbi shumë tryeza të vogla, portrete burrash të vjetër me favorite e me mjekra; ishin të parët e Andresë, të gjithë kishin qenë katolikë militantë.

Megjithëse të vdekur, prania e tyre ndihej ende në shtëpi dhe Andrea dukej sikur nuk ishte në vendin e saj midis atyre zotërinjve aq të rreptë: tepër e re, tepër e brishtë, e, mbi të gjitha, tepër e gjallë!

Kumboi një zile dhe ne shkuam në sallën e ngrënies. Sa shumë njerëz kishte! I njihja të gjithë, përveç gjyshe: rrethuar nga tufat e bardha të flokëve, ajo kishte një fytyrë të vërtetë gjysheje, nuk më la ndonjë përshtypje të veçantë. Vëllai më i madh, i sapokthyer nga seminari, ishte i veshur me rasë. Bashkë me Malunë dhe me zotin Galar i kishte hyrë një bisede tashmë të përhershme për votën e grave; po, ishte skandal i vërtetë që një nënë familjeje të kishte më pak të drejta se një punëtor krahu pijanec: por zoti Galar hidhej e thoshte se midis punëtorëve, gratë anojnë nga të kuqtë më shumë sesa burrat; nëse ligji kalonte, do t'u shërbente armiqve të kishës. Andrea nuk fliste. Në krye të tavolinës, binjaket gjuheshin me toptha buke; zonja Galar nuk ndërhynte, vetëm i ndiqte duke buzëqeshur. Për herë të parë mendova, krejt e bindur, se ajo buzëqeshje fshihte një grackë. Shpeshherë e kisha pasur zili pavarësinë e Andresë; befas, ajo m'u duk shumë më pak e lirë sesa unë. Kishte gjithë atë të kaluar nga pas; përreth saj kjo shtëpi e madhe, kjo familje e shumtë në numër: një burg, ku shtigjet dalëse ruheshin me shumë kujdes.

- Atëherë? Ç'mendim ke për ne?- më tha Maluja me ton gati të ashpër.

- Unë? Asgjë, përse?

- E kalove vështrimin nëpër të gjithë tavolinën; pa dyshim që ke menduar diçka.

- Mendova që jeni një familje e madhe në numër, vetëm kaq,- u përgjigja.

Por, thashë me vete, këndeje e tutje duhet ta kontrolloja më mirë shprehjen e fytyrës sime.

Kur u ngritëm nga tryeza, zonja Galar i tha Andresë:- Përse nuk ia tregon parkun Silvisë?

- Po,- tha Andrea.

- Merrni palltot, mbrëmja është e ftohtë.

Andrea mori dy mantele të leshta. Pëllumbat kishin rënë në gjumë. Dolëm nga dera e pasme që të nxirrte te ndërtesat plotësuese të vilës. Një qen-ujk, i lidhur te kolibja pranë stivës së druve, lehte duke tërhequr fort zinxhirin. Andrea iu afrua kolibes:

- Eja me ne të bëjmë një shëtitje, Mirza ime e gjorë.- E zgjidhi qenin që iu hodh gjithë gëzim përsipër dhe u nis me vrap para nesh.

- Beson se kafshët kanë shpirt?- më pyeti Andrea.

- Nuk di ç'të them.

- Në qoftë se nuk kanë, është një padrejtësi e madhe. Ato vuajnë njësoj si njerëzit. Dhe nuk e kuptojnë përse,- shtoi.- Të mos kuptosh, është shumë më keq.

Nuk u përgjigja. Sa shumë e kisha pritur atë mbrëmje! Mendoja se më në fund do të depërtoja në zemër të jetës së Andresë; por kurrë nuk më ishte dukur aq e largët. Tani që e fshehta e saj kishte një emër, nuk ishte më e njëjta Andre. Ecëm në heshtje nëpër një shteg të braktisur, mbushur me mëllaga e luleqielli. Parku ishte plot me lule e pemë të bukura.

- Ulemi aty,- tha Andrea duke më treguar një bankinë në këmbë të një kedri blu. Nxori nga çanta një paketë cigaresh.- E do një?

- Jo,- thashë.- Qëkur ke filluar të pish duhan?

- Mamaja ma ka ndaluar, por kur fillon e nuk bindesh...

Ndezi një cigare dhe tymi që lëshoi, i hyri në sy. Unë mblodha gjithë guximin që munda:- Andre, çfarë po ndodh? Më thuaj.

- Ma ha mendja se të ka vënë në dijeni mamaja. Nguli këmbë të vinte të të merrte...

- Më foli për mikun tënd, Bernardin. Ti nuk më ke treguar kurrë asgjë.

- Nuk flisja dot për Bernardin,- tha Andrea; hapi dorën e majtë dhe pastaj e shtrëngoi me forcë.- Po tani e kanë marrë vesh të gjithë.

- Po nuk deshe, nuk flasim,- thashë me të shpejtë.

Andrea më shikoi:- Me ty është ndryshe; ty kam dëshirë të të tregoj.- Nxori një shtëllungë tjetër tymi.- Çfarë të tha ime më?

- Se si zutë miqësi ti dhe Bernardi e pastaj më tha se nuk të lejon ta takosh.

- Ma ka ndaluar,- tha Andrea; e flaku cigaren dhe e shkeli me thembrën e këpucës.- Atë mbrëmje kur erdha këtu, pas darke, dola të shëtisja me Bernardin; u ktheva vonë. Mamaja po më priste, e vura re menjëherë që kishte një shprehje të çuditshme në fytyrë. Më bëri njëqind pyetje.- Andrea mblodhi supet dhe tha me acarim:- Më pyeti nëse u puthëm! Sigurisht që u puthëm! Ne duhemi.

Ula kokën. Andrea ndihej e palumtur dhe kjo ide më dukej e padurueshme; por fatkeqësia e saj për mua ishte krejt e huaj: këto dashuritë me të puthura, më dukeshin krejtësisht të pavërteta.

- Mamaja më tha gjëra të tmerrshme,- tha Andrea. U mbështoll me mantelin e leshtë.

- Po pse?

- Prindërit e tij janë shumë më të pasur se të mitë, por nuk janë të sërës sonë. Me sa duket atje, në Rio, bëjnë një jetë ekstravagante, të çrregullt,- tha Andrea me ton prej puritaneje. Dhe shtoi, duke mërmëritur:- E ëma e Bernardit është dhe çifute.

Vështrova Mirzën që po rrinte pa lëvizur në mes të barit, me veshët ngritur drejt yjeve: tani edhe për mua, si dhe për të, ishte e pamundur të shprehja me fjalë ato që ndieja.

- Atëherë, si i bëhet?- pyeta.

- Mamaja foli me babanë e Bernardit; edhe ai është në një mendje me të, se unë nuk jam gruaja e duhur. Ka vendosur ta shpjerë Bernardin në Biarritz për pushime dhe pastaj do të nisen për në Argjentinë. Tani Bernardi nuk ka më probleme me shëndetin.

- Është nisur, kështu?

- Po, mamaja nuk më la ta përshëndesja, por unë nuk iu binda. Ajo nuk e kupton,- tha Andrea,- që nuk ka gjë më të tmerrshme sesa të bësh të vuajë atë që dashuron.- Asaj i dridhej zëri.- Ai qau. Oh, ta dish sa qau!

- Sa vjeç është?- e pyeta.- Ma përshkruaj pak.

- Është pesëmbëdhjetë vjeç, sa unë. Por, ai nuk e njeh fare jetën,- tha Andrea.- Nuk ka pasur asnjë shok a shoqe, përveç meje.- Ajo kërkoi diçka në çantë.

- Kam një fotografi të vogël të tij.

Vështrova djalin e vogël e të panjohur që dashuronte Andrea, të cilin e puthte dhe për të cilin kishte qarë shumë. Kishte sy të mëdhenj e të çelët, me qepalla të fryra, flokë të errët, të prerë model prej perandori romak ngjante krejt si Shën Tarcisi i martirizuar.

- Nga sytë dhe faqet duket si një djalë i vërtetë,- tha Andrea,- por, buzët e tij kanë një shprehje të trishtë: sikur i kërkon falje gjithë botës.

E mbështeti kokën pas, te shpinorja e bankinës dhe vështroi qiellin:

- Nganjëherë them me vete se do të ishte më mirë sikur ai të vdiste; të paktën do të vuaja vetëm unë.

Dhe përsëri shtrëngoi grushtin fort, me drithërimë.

- Nuk duroj dot kur mendoj se në këtë çast ai është duke qarë.

- Ju do të takoheni një ditë!- i thashë.- Përderisa duheni me njëri-tjetrin, keni për t'u takuar! Sepse, do vijë koha kur do të jeni të rritur.

- Pas dhjetë vjetësh. Tepër vonë. Për moshën tonë është tepër vonë. Jo,- tha Andrea me dëshpërim,- unë e di shumë mirë se nuk do ta shoh më kurrë.

Kurrë! Ishte e para herë që kjo fjalë po më binte mu në zemër si gur i rëndë; e përsërita me vete, poshtë atij qielli të pambarimtë dhe më erdhi për të qarë.

- Kur u ktheva në shtëpi, pasi i dhashë lamtumirën,- tha Andrea,- u ngjita lart mbi çati... doja të hidhesha.

- Doje të vrisje veten?

- Qëndrova dy orë atje sipër; ngurrova për dy orë të tëra. Thosha me vete se nuk më bëhej vonë, nëse do të përfundoja në ferr: në qoftë se Zoti nuk është i mirë, nuk më intereson aspak të shkoj në qiellin e tij.

Andrea mblodhi supet:

- Gjithsesi, pata edhe pak frikë. Oh! Jo nga vdekja, përkundrazi, dua kaq shumë të vdes! Por nga ferri. Po të përfundoj në ferr, ka marrë fund

përjetësisht, se nuk do ta shoh më kurrë Bernardin.

- Do ta takosh në këtë jetë!- i thashë unë.

Andrea tundi kokën:- Ka marrë fund.

Dhe u ngrit me vrull.- Shkojmë në shtëpi. Kam ftohtë.

E përshkuam lëndinëzën në heshtje. Andrea lidhi Mirzën, pastaj u ngjitëm në dhomë. Unë rashë të flija te shtrati me baldakin, ndërsa ajo në divanin që hapej. Shoi abazhurin e saj.

- Nuk i kam treguar mamit se e takova përsëri Bernardin,- më tha.- Nuk ia dëgjoj dot fjalët që do të më thotë.

Unë u përtypa. Zonja Galar nuk më pëlqente asfare, por Andresë duhet t'i thosha të vërtetën:

- Ajo shqetësohet shumë për ty,- i thashë.

- Posi, e marr me mend se sa shumë shqetësohet,- tha Andrea.

* * *

Në ditët në vijim, Andrea nuk e zuri më ngoje Bernardin dhe unë nuk guxoja ta përmendja e para. Në mëngjes, ajo luante gjatë në violinë dhe pothuajse përherë pjesë të trishtuara. Më pas dilnim e rrinim në diell. Ajo krahinë ishte më e ashpër sesa imja, përgjatë shtigjeve me pluhur mësova të ndieja aromën e fortë të fiqve; në pyll njoha shijen e boçave të pishës, thitha lotët prej rrëshire të trungjeve të atyre pishave. Kur ktheheshim nga shëtitjet, Andrea futej në stallë, ledhatonte kalin e saj të vogël me krifën e zbardhëlleme, por tek i cili nuk hipte kurrë.

Pasditet tona ishin më pak të qeta. Zonja Galar i kishte hyrë punës të martonte Malunë dhe, që të mos binin në sy vizitat e djemve të rinj pak a shumë të panjohur, i hapte tejtejt dyert e shtëpisë ndaj rinitë “për së mbari” të rrethinave. Luhej kriket, tenis, vallëzohej përmbi lëndinë, flitej për shiun e për kohën e mirë e haheshin ëmbëlsira. Ditën kur Maluja zbriti nga dhoma e saj me një fustan *shantung écru*, me flokët e sapolarë dhe me onde të sajuara me shufër hekuri, Andrea më ra me bërryl:

- Është veshur për takim.

Maluja e kaloi pasditen pranë një djaloshi nga Saint-Cyr, tepër i shpifur, i cili nuk luante as tenis, as nuk vallëzonte e as nuk bisedonte: herë pas here

mblidhte tophat tanë. Pasi ai u largua, zonja Galar u mbyll në bibliotekë me bijën e saj të madhe; dritarja ishte e hapur dhe ne dëgjuam zërin e Malusë:- Jo, mami, jo atë: është shumë i mërzitshëm!

- E shkreta Malu!- tha Andrea.- Gjithnjë e prezantojnë më tipa të tillë idiotë e budallenj!

U ul te shilarësi; përjashta, pranë haurit kishin krijuar një lloj palestres; Andrea aty stërvitej gjithnjë te trapezi apo te paralelet, ishte shumë e zonja në të dyja. Kapi litarët:- Më shtyj.

E shtyva; kur mori pak vrull u ngrit në këmbë dhe i dha një të shtyrë të fortë me këmbë; menjëherë shilarësi fluturoi drejt majave të pemëve.

- Jo aq lart!- thirra.

Ajo nuk u përgjigj; ngrihej sipër, binte poshtë dhe fluturonte edhe më lart akoma. Të dyja binjaket, që po luanin me sharrën e druve, pranë kolibes së qenit, ngritën kokën e filluan të vështronin me kureshtje; së largu dëgjohej zhurma e thatë e raketave që gjuanin topat. Tanimë Andrea po çikte gjethet e pemëve dhe mua më hyri frika: ganxhat e çelikta po gërvinin.

- André!

Shtëpia kishte rënë në heshtje të thellë; nga dritareza e kuzhinës vinte ndonjë zhurmë e lehtë; buzë murit vjollcat dhe lulehënat dridheshin sapak. Unë po trembesha për vdekje. Nuk guxoja të kapesha pas ndenjës së shilarësit, as t'i thërrisja me zë shumë të lartë; por tmerrohesha mos përmysej shilarësi ose se mos Andresë i merreshin mendtë dhe i shkisin duart nga litarët. Po më përzihej vetëm duke parë lëkundjet e atij lavjerrësi të çmendur drejt qiellit. Përse po lëkundej kaq fort? Kur më afrohej, me trupin drejt, veshur me fustanin e bardhë, e shihja se sytë i kishte të shqyer tej mase dhe buzët e shtrënguara. Ndoshta i qe krisur diçka në tru dhe nuk mund të ndalej më. Ra zilja për të ngrënë darkë dhe Mirza filloi të lehte me të madhe. Andrea vazhdonte të fluturonte mes pemëve. "Do të vrasë veten", mendova.

- André!

Kishte thirrur dikush tjetër. U afrua zonja Galar, e nxirë në fytyrë nga inati.

- Zbrit menjëherë! Po të urdhëroj. Zbrit!

Andrea puliti sytë dhe vështroi poshtë; u kërrus, u ul dhe frenoi këmbët me kaq shpejtësi sa ra e u shtri gjerë e gjatë përmbi bar.

- U vrave?

- Jo.

Filloi të qeshte, por e qeshura iu shndërrua në një rënkim dhe ajo mbeti aty, përdhé, me sytë e mbyllur.

- Ti nuk je në vetë! Ke gjysmë ore në atë shilarës! E di sa vjeçe je?- tha zonja Galar me zë të rëndë.

Andrea hapi sytë.

- Më merren mendtë.

- Kishe për detyrë të përgatisje një tortë për nesër pasdite.

- Do ta bëj pas darkës,- tha Andrea dhe u ngrit. Më vuri dorën në sup.- Nuk më mbajnë këmbët.

Zonja Galar iku; mori për dore dy binjaket dhe shkoi drejt shtëpisë. Andrea ngriti kokën dhe vështroi majat e pemëve.

- Sa bukur ishte atje lart,- tha.

- Më trembe shumë,- i thashë unë.

- Oh! Shilarësi është mjaft i fortë, kurrë nuk ka ndodhur asnjë aksident,- tha Andrea.

Jo, nuk paskësh pasur në mendje vetëvrasjen; ajo çështje ishte e zgjidhur; por kur kujtoja sytë e saj të shqyer dhe buzët e shtrënguara, më zinte përsëri frika.

Pas darkës Andrea dhe unë shkuam në kuzhinë, ku nuk kishte më njeri; ajo ishte shumë e madhe dhe zinte gjysmën e hapësirës së katit përdhes; gjatë ditës, përmes dritarezës mund të shihje përjashta ku ecnin këmbë gjelash deti, qensh, po edhe këmbë njerëzish; por në këtë orë jashtë nuk lëvizte asgjë, vetëm Mirza hungërinte lehtë-lehtë lidhur te zinxhiri. Në sobën prej gize brambullinte zjarri; nuk dëgjohej asnjë zhurmë tjetër. Ndërkohë që Andrea thyente vezët, përgatiste masat e sheqerit e të majasë, unë kundroja muret, hapja bufetë. Ishin plot e përplot me sende bakri të shndritshëm: seri tenxheresh, qepshe, bragaçe, ngrohëse shtrati të dikurshme, me të cilat ishin ngrohur ata mjekroshët paraardhës; mbi raftin e enëve admirova kompletin e pjatave prej smalti e me ngjyra të këndshme. Dhe një numër i pafund enësh prej gize, qeramike, guri, porcelani, alumini, kallaji, lloj-lloj kusish, tiganësh, enësh qeramike, tenxheresh me kapak, të përshtatshme për gjithfarë gatimesh, pjatanca, poçe, supiere, pjata, kupa, kullojsa, makina grirëse mishi, mullinj, kallëpe për forma gatimi dhe havanë! Gjithfarëlloj tasash, gotash vere dhe gotash për shampanjë, pjata,

pjata filxhanësh; katruve, shtamba, karafe! Gjithë këto lloj lugësh, garuzhdash, pirunësh, thikash kishin nga një funksion të caktuar? Pse, secili prej nesh kishte kaq nevoja për të plotësuar? Kjo botë e fshehur u dashka të shfaqej në sipërfaqen e tokës nëpërmjet festave të stërmëdha e elegante, por që, me aq sa dija, nuk organizoheshin askurrkund.

- I përdorni të gjitha këto?- e pyeta Andrenë.

- Pak a shumë: kemi tradita me tepri,- tha ajo. Pastaj futi në furrë një tavë me masën e tortës brenda.

- Nuk ke parë asgjë, akoma,- shtoi.- Eja të bëjmë një shëtitje në kantinë.

Në krye hymë në pjesën e bulmetit: kavanoza të panumërt, të lyer me bojë, poçe prej druri të lëmuar, tasa balte me gjalpë, djathë i bardhë i freskët e i butë, mbështjellë me muslinë të bardhë: ajo lakuriqësi higjienike dhe ajo aromë si prej të porsalinduri më shtynin t'ia mbathja sa më parë prej andej. Më pëlqyen më shumë qilarët e mbushur me shishe të pluhurosura dhe butet e vogla me alkool; por edhe sasia e madhe e proshutave, e salsiçeve dhe patateve më vështirosi stomakun.

“Ja përse ajo ka nevojë të fluturojë mes pemëve”, mendova, duke vështruar Andrenë.

- Të pëlqejnë qershitë e konservuara?

- Nuk i kam provuar asnjëherë.

Mbi një raft pashë qindra kavanoza me reçelra: secili syresh i mbuluar me një copë letre ku ishte shkruar një datë dhe emri i frutës. Kishte edhe poçe me fruta të konservuara në shurup dhe në alkool. Andrea mori një poçe me qershi dhe e çoi në kuzhinë. E vendosi mbi tryezë. Mori dhe një lugë druri dhe mbushi dy tasa prej poçes; e provoi shijen që nga luga e drunjtë:

- Gjyshja e ka pasur pak dorën e rëndë,- tha.- Kështu do të dehemi e do të bëhemi tapë!

Kapa nga bishti një kokërr të çngjyrosur, pakëz të fishkur e të zhveshur nga cipa: nuk kishte më shijen e qershisë, por shija e alkoolit më pëlqeu. E pyeta:- Të ka qëlluar të dehesh?

Fytyra e Andresë u përndrit:

- Një herë, me Bernardin. Kishim pirë një shishe me Chartreuse. Në krye u kënaqëm, m'u morën mendtë më shumë sesa kur zbres nga shilarësi. Por më vonë na vinte për të vjellë.

Zjarri bubullinte; në hundë na erdhi një aromë e butë ëmbëlsire. Meqenëse Andrea e përmendi vetë emrin e Bernardit, unë guxova dhe e pyeta:- Zuté miqësi pas atij aksidentit që pësove? Vinte shpesh të të shihte?

- Po. Luanim damë, domino, *crapette*.^[2] Asokohe Bernardi nxehej shpejt; një herë e akuzova se bënte hile dhe ai më gjuajti me shkelm: mu te kofsha e djathtë, po nuk e bëri me dashje. Mua më ra të fikët nga dhimbja. Kur erdha në vete, ai thirri për ndihmë, më fashuan edhe një herë, ndërsa ai qante e rënkonte pranë shtratit.

Andrea hodhi shikimin diku larg.

- Kurrë nuk kisha parë një djalë të qante; vëllezërit dhe kushërinjtë e mi ishin harbutë. Kur mbetëm vetëm, ne u puthëm...

Andrea i mbushi përsëri dy gotat; aroma po forcohej; e kuptuam se ëmbëlsira në furrë po merrte ngjyrën e arit përsipër. Mirza nuk hungërinte më, me sa dukej po flinte, të gjithë po flinin.

- Filloi të më dashuronte,- tha Andrea.

U kthye e më vështroi.- Nuk ta shpjegoj dot se si ndryshoi katërcipërisht jeta ime! Gjithnjë kisha menduar se mua askush nuk mund të më dashuronte.

U drodha.- Kështu mendoje?

- Po.

- Po përse?- e pyeta e shastisur.

Ajo mblodhi supet.- Më dukej vetja kaq e shëmtuar, kaq e ngathët, kaq pak tërheqëse; nga ana tjetër, është e vërtetë se askush nuk e vriste mendjen sadopak për mua.

- Po mamaja jote?- thashë.

- Oh! Nëna duhet t'i dojë fëmijët e saj, ajo nuk quhet. Mamaja na donte të gjithëve dhe ne ishim kaq shumë!

Në zërin e saj ndjeva njëfarë neveritjeje. Mos kishte qenë xheloze për vëllezërit e motrat? Mos kishte vuajtur prej asaj ftohtësisë që unë e ndieja te zonja Galar? Kurrë nuk më kishte shkuar në mendje se dashuria e saj për të ëmën, mund të ishte një dashuri fatkeqe. Ajo mbështeti bërrylat mbi sipërfaqen e drunjtë e të ndritshme të tavolinës.

- Askush tjetër në këtë botë, përveç Bernardit, nuk më ka dashur për atë që jam, ashtu si isha, pikërisht sepse isha unë,- tha me një zë të mbushur me krenari.

- Po unë?- i thashë.

Fjalët më shpëtuan padashur; isha e zemëruar nga ajo padrejtësi aq e madhe. Andrea më vështroi me habi.- Ti?

- Nuk të kam dashur unë për atë që ti je?

- Sigurisht,- tha Andrea, si në mëdyshje.

Ngrohtësia e alkoolit dhe mëria më kishin trimëruar; doja t'i thosha Andresë nga ato gjërat që thuhën vetëm në libra.

- Nuk e ke kuptuar kurrë, por që ditën që jemi takuar, ti ke qenë gjithçka për mua,- i thashë.- E kisha vendosur që, nëse ti do të vdisje një ditë, do të vdisja dhe unë menjëherë pas teje.

Po flisja në kohën e shkuar dhe përpiqesha të ruaja një ton shkëputjeje. Andrea vazhdonte të më shihte me hutim.

- Pandehja se për ty asgjë nuk kishte rëndësi përpara librave dhe studimeve.

- Derisa të njoha ty,- thashë.- Do të hiqja dorë nga të gjitha, vetëm mos të të humbisja.

Ajo nuk foli dhe unë e pyeta:- Nuk ke dyshuar kurrë?

- Kur më dhurove atë çantën për ditëlindje, mendova se ti provoje ndjenja të vërteta miqësie për mua.

- Ishte shumë më tepër se aq!- thashë me hidhërim.

Andrea dukej e mallëngjyer. Po përse nuk kisha ditur t'ia bëja ta ndiente dashurinë time? E mendoja tepër të zonzjën, se i mjaftonte vetvetja. Doja të qaja për të dhe për veten.

- Është e çuditshme,- tha Andrea:- ne kemi qenë të pandara për shumë vite dhe vetëm tani po e kuptoj se nuk të kam njohur! I gjykoj njerëzit pa u menduar shumë,- tha, gjithë pendesë.

Nuk dëshiroja që ajo të ndihej në faj:

- Edhe unë, edhe unë të njoh shumë pak,- i thashë me të shpejtë.- Kujtoja se ndiheshe krenare që ishe ashtu siç ishe dhe të kisha zili.

- Nuk ndihem krenare,- tha.

U ngrit dhe shkoi te soba.- Keku u poq,- tha, duke hapur furrën.

Shoi zjarrin dhe e vendosi ëmbëlsirën në raftin e ushqimeve. U ngjitëm në dhomë dhe, ndërsa po zhvisheshim, më pyeti:- Do vish nesër të kungohesh?

- Jo,- iu përgjigja.

- Atëherë shkojmë bashkë te mesha e madhe. Edhe unë nuk kungohem më. Jam në fazë mëkatimi,- shtoi me mospërfillje:- mamasë nuk i kam thënë kurrë që nuk i jam bindur dhe, më të keqen akoma, që nuk pendohem aspak.

U futa në shtratin me kolonat e përdredhura dhe u mbulova mirë e mirë.- Por, nuk mund të mos takoheshe me Bernardin, para se ai të largohej.

- Nuk mundja!- tha Andrea.- Do të pandehte se ai për mua nuk kishte rëndësi dhe do të dëshpërohej edhe më shumë. Nuk mundja,- përsëriti.

- Atëherë, bëre mirë që nuk u binde,- i thashë.

- Oh!- tha Andrea,- nganjëherë, çfarëdo që bëjmë, është gjithnjë vetëm e keqe.

U shtri, por e la të ndezur dritën e kaltër në krye të shtratit.

- Kjo është një nga gjërat që nuk e kuptoj,- tha.- Përse Zoti nuk e na e thotë qartazi se çfarë kërkon prej nesh?

Nuk fola; Andrea u rrotullua nëpër shtrat për të ndrequr nënkresat.- Dua të të pyes për diçka.

- Më thuaj.

- A beson gjithnjë në Zot?

Nuk ngurrova; atë mbrëmje e vërteta nuk më trembte.

- Nuk besoj më,- i thashë.- Ka rreth një vit që nuk besoj më.

- E kisha këtë dyshim,- tha Andrea.

Dhe u ngrit e u mbështet te nënkresat:- Silvi! Nuk është e mundur që të ekzistojë vetëm kjo jeta këtu!

- Nuk besoj më,- përsërita.

- Nganjëherë është e vështirë,- tha Andrea.- Përse Zoti dëshiruaka që ne të jemi fatkeqë? Im vëlla më shpjegon se etërit e Kishës e kanë zgjidhur me kohë problemin e së keqes, më përsërit ato që i mësojnë në seminar, por nuk arrin të më mbushë mendjen.

- Nëse Zoti ekziston, e keqja nuk do të kishte kuptim,- thashë unë.

- Ndoshta duhet të pranojmë se ka gjëra që nuk mund të kuptohen,- tha Andrea.- Dëshira për të kuptuar gjithçka, është mëkati i kryelartësisë.

E shoi dritën e vogël dhe shtoi me zë fare të ulët:- Ekziston një jetë tjetër, me siguri. Duhet të ketë një jetë tjetër!

Kur u zgjova, nuk e dija mirë se çfarë duhej të prisja: dhe u zhgënjeva. Andrea ishte po ajo e para, si edhe unë, i thamë mirëmëngjesi njëra-tjetrës, siç

kishim bërë çdo ditë. Por, zhgënjimi më zgjati edhe në ditët që pasuan. Sigurisht, ne ishim aq të bashkuara sa nuk mund të bashkoheshim dot edhe më shumë; pas gjashtë vjetësh miqësie, disa fraza nuk kanë më rëndësi; por, kur e kujtoja atë orë që kaluam në kuzhinë, brengosësja që, në të vërtetë, nuk kishte ndodhur asgjë.

Një mëngjes ishim ulur poshtë një fiku dhe po hanim fiq; ata të mëdhenjtë bojë mavi që shiten në Paris janë pa shije, si perime, kurse këta këtu, të vegjël, në bojë të çelët, të mbushur me një masë si marmelatë e ëmbël, më pëlqenin shumë.

- Mbrëmë fola me mamanë,- më tha Andrea.

Më sëmboi zemra; kur Andrea largohej prej së ëmës, më dukej më afër meje.

- Më pyeti nëse do të kungohem të dielën. Ishte tronditur shumë që nuk u kungova të dielën që shkoi.

- E mori me mend arsyen?

- Jo plotësisht. Por, ia tregova.

- Ah! Ia the?

Andrea mbështeti faqen pas trungut të fikut:- E gjora mama! Ka gjithë ato telashe në këtë moment: për shkak të Malusë dhe për shkakun tim!

- Të qortoi?

- Më tha se ajo vetë më falte, pjesa tjetër më takonte mua dhe rrëfyestarit tim.- Andrea më vështroi hijerëndë:- Duhet ta kuptojmë,- tha.- I duhet të kujdeset për shpirtin tim: por edhe ajo nuk e ka të qartë se çfarë kërkon Zoti prej saj. Nuk është e lehtë për askënd.

- Jo, nuk është e lehtë,- thashë përhumbtazi.

Vloja nga zemërimi. Zonja Galar e torturonte Andrenë dhe ja ku na dilte se viktima ishte ajo vetë!

- Mamaja më foli në një mënyrë të atillë, sa më çoroditi,- tha Andrea, me zë të mallëngjyer.- Sepse, që ta dish, edhe ajo, kur ka qenë e re, ka kaluar çaste të vështira.

Vështroi përçark.- Madje dhe këtu, në këtë vend, ka kaluar periudha të rënda.

- Gjyshja jote ishte shumë autoritare?

- Po.

Andrea ra në mendime për një grimë:

- Mamaja thotë se ekzistojnë disa favore, disa dhurata të Zotit, me të cilat Ai mat provat që na dërgon, se do ta ndihmojë Bernardin e do të më ndihmojë edhe mua, ashtu siç ka ndihmuar dikur atë.

Kërkoi vështrimin tim.- Silvi, në qoftë se ti nuk beson në Zot, si mund të durosh e të jetosh?

- Po mua më pëlqen të jetoj,- thashë.

- Edhe mua. Por, ja ku na del çështja: po të besoj se njerëzit që dua, do të vdesin përgjithmonë trup e shpirt bashkë, do të vrisja veten menjëherë.

- Mua nuk më shkon kurrë mendja të vras veten,- thashë.

U larguam nga hija e fikut dhe u kthyem në heshtje në shtëpi. Të dielën tjetër

Andrea shkoi të kungohej.